REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 936/20
Datë/Datum. 10.12.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr.936/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Blerim Dina – Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Goran Milenkovic – Anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "Illyrian Consulting Engineers"-Tiranë, kundër njoftimit për anulim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Hartimi i vlerësimit strategjik të mjedisit si dhe hartës zonale të Komunës së Shtërpcës, Komuna Shtërpcë" me nr. të prokurimit: 655-20-6077-2-1-3, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- "KK-Shtërpcë", më datën: 09.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "Illyrian Consulting Engineers"-Tiranë, kundër njoftimit për anulim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Hartimi i vlerësimit strategjik të mjedisit si dhe hartës zonale të Komunës së Shtërpcës, Komuna Shtërpcë" me nr. të prokurimit: 655-20-6077-2-1-3, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- "KK-Shtërpcë".

II. VËRTETOHET, njoftimi për anulim lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Hartimi i vlerësimit strategjik të mjedisit si dhe hartës zonale të Komunës së Shtërpcës, Komuna Shtërpcë" me nr. të prokurimit: 655-20-6077-2-1-3, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- "KK-Shtërpcë".

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "Illyrian Consulting Engineers"-Tiranë, aprovohet si pjesërisht e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues "Illyrian Consulting Engineers"-Tiranë ,si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 13.11.2020 me nr. 936/20, kundër njoftimit për anulim , lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Hartimi i vlerësimit strategjik të mjedisit si dhe hartës zonale të Komunës së Shtërpcës, Komuna Shtërpcë" me nr. të prokurimit: 655-20-6077-2-1-3, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- "KK-Shtërpcë", duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 7, 62 dhe 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe nenin 43 , 44 të RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konfirmon nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 20.11.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 30.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në Pretendimet ankimore:

Eksperti Shqyrtues vlerëson se pretendimet ankimore janë plotësisht të qëndrueshme pasi Autoriteti Kontraktues anulimin e aktivitetit të prokurimit nuk e ka bërë në përputhje me dispozitat e nenit 62 të LPP-së për arsye se nuk e ka bërë me kohë hapjen e ofertave në afatin e përcaktuar. Eksperti vërteton se në njoftimin për konkurs projektimi shkruan se dorëzimi i ofertave do te behet përmes e –sistemit dhe njëkohësisht AK ka a qenë në njohuri se nga viti 2019 të gjitha prokurimet udhëhiqen përmes e-prokurimit me përjashtim të kontratave me vlerë minimale, prandaj edhe nëse janë dorëzuar oferta në forme fizike nënkupton se kanë qenë oferta të pavlefshme dhe ka qene përgjegjësi e AK-se qe ti përmbahet dispozitave te LPP-së qe ofertat e pranuara ne e-prokurim ti hap në kohën e përcaktuar, edhe në rast se ka pasur ndonjë paqartësi AK ka pas për obligim që me kohe të bej korrigjimet e nevojshme dhe të shtyj afatin e hapjes, e jo të pres të kaloj afati i

hapjes publike pasi që nën kupton se nëse hapja publike nuk behet në kohen siç është përcaktuar në e prokurim te gjitha oferta e dorëzuara përmes e-prokurimit digjen, qa do te thotë se teknikisht është e pa mund te bëhet hapja e ofertave pasi të kaloj afati i rregullt për haje e që ka qen data 27.10.2020. Ne e-prokurim përveç që nuk gjendet oferta e OE ankues nuk gjinden as oferta tjera qa do të thotë se teknikisht e-prokurim nuk mundëson që të behet hapja publike, pasi ka kaluar afati rregullt.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke iu referuar këtij aktiviteti të prokurimit AK nuk ka respektuar dispozitat e nenit 58 te LPP-se dhe kjo bie ndesh me dispozitat e nenit 7 të këtij ligji, andaj pretendimet ankimore konsiderohen të bazuara por duke pasur parasysh mundësit teknike të platformës elektronike është e pa mundur te ketë hapje publike te ofertave, andaj Eksperti Shqyrtues i rekomandon Panelit Shqyrtues qe vendimi i autoritetit kontraktues të mbete në fuqi dhe përkundër parregullsive që janë bërë nga ana e AK-së.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 30.11.2020 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 30.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik "Illyrian Consulting Engineers"-Tiranë, me datë: 04.12.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Të nderuar/a, Me këtë letër dhe në emër të "Illyrian Consulting Engineers SHPK" dua të ju konfirmoj se kemi pranuar ekspertizën e Ekspertit Shqyrtues me numër 963/20 në datën 04.12.2020 të cilën e pranojmë për nga mënyra e trajtimit të pretendimeve tona por e KUNDËRSHTOJMË në tërësi mendimin përfundimtarë të Ekspertit Shqyrtues. Sipas Ekspertit Shqyrtues ankesa jonë del të jetë plotësisht e bazuar dhe po ashtu konstatohet se AK nuk ka respektuar dispozitat e LPP-së me Të nderuar/a, Me këtë letër dhe në emër të "Illyrian Consulting Engineers SHPK" dua të ju konfirmoj se kemi pranuar ekspertizën e Ekspertit Shqyrtues me numër 963/20 në datën 04.12.2020 të cilën e pranojmë për nga mënyra e trajtimit të pretendimeve tona por e KUNDËRSHTOJMË në tërësi mendimin përfundimtarë të Ekspertit Shqyrtues. Sipas Ekspertit Shqyrtues ankesa jonë del të jetë plotësisht e bazuar dhe po ashtu konstatohet se AK nuk ka respektuar dispozitat e LPP-së me **mos hapjen** publike të ofertave.

Sipas informatave të marrura në KRPP përkatësisht nga stafi i cili e mbikëqyrë funksionimin e mirëfilltë të sistemit të prokurimit elektronik, del që ekziston si mundësi që AK në bashkëpunim me KRPP të bëjnë hapjen publike të ofertave edhe pasi të kaloj afati për hapje publike sipas datës së paraparë. Bazuar në këtë

mendojmë se është e pa drejtë që për fajin e AK-së që nuk ka respektuar dispozitat ligjore të sanksionohemi ne me mos mundësi të fitimit të këtij tenderi. Ne kemi qenë të vetmit që kemi aplikuar ashtu siç e parasheh ligji dhe dosja e tenderit. Nisur nga ky fakt, hapja publike nën mbikëqyrjen e KRPP- së nuk do shkaktonte asnjë problem dhe gjithashtu do ishte edhe në përputhje me të gjitha dispozitat Ligjore. Ne besojmë se AK qëllimisht nuk i ka futur çelësat me kohë për ta bërë hapjen publike duke e shtyrë procesin drejt dështimit të tij. AK nuk po sanksionohet fare për këtë veprim antiligjor ndërsa ne si OE i vetëm që kemi aplikuar në përputhje me ligjin dhe dosjen e tenderit po dëmtohemi që në kushte normale jemi fitues potencial i këtij tenderi. Eksperti Shqyrtues mendojmë se nuk ka vepruar sipas ligjit dhe nuk e ka aplikuar atë si duhet për rrethanat krijuara me ç'rast kundërligjshëm ka dhënë mendim që të përkrahet vendimi i AK-së edhe pse i konsideruar nga vet eksperti si i kundërligjshëm. Pranimi i ankesës tonë si e bazuar nuk është i mjaftueshëm po që se nuk detyrohet AK të bëjë hapjen publike. Andaj bazuar në të gjitha këto që i potencuam më lartë, kërkojmë nga Kryetari i OSHP-së, z. Blerim Dina që të merr për bazë kërkesën tonë dhe ta aprovoj ankesën tonë si të bazuar duke e detyruar AK që përmes mbështetjes nga IT e KRPP-së, të bëjë hapjen publike të ofertave dhe të vazhdoj me procesin e vlerësimit të tyre. Ne mbetemi me shpresë se OSHP do të veproj drejt në parandalimin e kësaj shkeljeje dhe do ta aprovoj kërkesën tone ,me rast AK do të detyrohet ta bëj hapjen publike,

Sinqerisht Olset Haxhiu.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 09.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Illyrian Consulting Engineers"-Tiranë, se AK e ka anuluar aktivitetin e prokurimit në kundërshtim me dispozitat e LPP-së, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se pretendimet ankimore janë plotësisht të qëndrueshme pasi autoriteti kontraktues anulimin e aktivitetit të prokurimit nuk e ka bërë në përputhje me dispozitat e nenit 62 të LPP-së për arsye se nuk e ka bërë me kohë hapjen e ofertave në afatin e përcaktuar. Po ashtu, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vërteton se në njoftimin për konkurs projektimi shkruan se dorëzimi i ofertave do të bëhet përmes e –sistemit dhe njëkohësisht AK ka qenë në njohuri se nga viti 2019 të gjitha prokurimet udhëhiqen përmes e-prokurimit me përjashtim të kontratave me vlerë minimale. Prandaj, edhe nëse janë dorëzuar oferta në forme fizike

nënkupton se kanë qenë oferta të pavlefshme dhe ka qene përgjegjësi e AK-së që ti përmbahet dispozitave të LPP-së që ofertat e pranuara në e-prokurim ti hap në kohën e përcaktuar, edhe në rast se ka pasur ndonjë paqartësi, AK ka pas për obligim që me kohe të bëjë korrigjimet e nevojshme dhe të shtyj afatin e hapjes, e jo të pres të kaloj afati i hapjes publike pasi që nënkupton se nëse hapja publike nuk bëhet në kohen siç është përcaktuar në e prokurim, të gjitha ofertat e dorëzuara përmes e-prokurimit digjen, që do të thotë se teknikisht është e pa mundur të bëhet hapja e ofertave pasi të kaloj afati i rregullt për hapje e që ka qenë data 27.10.2020. Në e-prokurim përveç që nuk gjendet oferta e OE ankues nuk gjinden as oferta tjera, do të thotë se teknikisht e-prokurim nuk mundëson që të behet hapja publike, pasi ka kaluar afati rregullt.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, shkresave të lëndës dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se iu referuar këtij aktiviteti të prokurimit, AK nuk ka respektuar dispozitat e nenit 58 të LPP-së dhe kjo bie ndesh me dispozitat e nenit 7 të këtij ligji. Andaj, pretendimet ankimore konsiderohen pjesërisht të bazuara por duke pasur parasysh mundësitë teknike të platformës elektronike është e pa mundur të ketë hapje publike të ofertave. Pra, duke pasur parasysh shkeljet procedurale të cilat kanë ndodhur për këtë aktivitet të prokurimit është e pamundur që të vazhdohet më tutje dhe me këtë rast duhet të anulohet ky aktivitet në bazë të nenit 62 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesues i Paneli Shqyrtues

Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK "KK-Shtërpcë";

1x1 OE "Illyrian Consulting Engineers"-Tiranë;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.